



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 13 – qershor - dhjetor 2015

- Seancat e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Shkeljet e të drejtave të njeriut në lëndët *Stanisic, Maksutaj dhe L.O.*
- Vendimet e pranueshmërisë në lëndët lidhur me vrasje dhe persona të zhdukur
- Vendimet pasuese në lëndën *X dhe 115 të tjerë dhe Becici*
- Vendimet shtesë
- Takimi me shefin e stafit të EULEX-it
- Fushata informuese
- Statistika e lëndëve

Seancat e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 26^{të} të rregullt nga data 15 deri me 17 qershor 2015. Paneli ka konstatuar tre lëndë të papranueshme. Gjithashtu ka hequr nga lista e ankesave një lëndë.

Paneli ka mbajtur seancën e radhës nga data 28 deri me 30 shtator 2015. Gjatë kësaj seance janë shqyrtuar tetë lëndë lidhur me hetimet e kryera nga EULEX-it rreth vrasjeve dhe zhdukjeve që kanë ndodhur në vitin 1999 dhe 2000. Paneli i ka gjetur ankesat të pranueshme në të gjitha rastet dhe ka kërkuar nga palët që të ofrojnë vërejtje shtesë mbi bazueshmërinë e ankesave.

Seanca e 28^{të} e Panelit është mbajtur nga 11 deri më 13 nëntor 2015. Në tre lëndë, Paneli ka shpallur se EULEX-i ka shkelur të drejtat e ankuesve. Një lëndë është shpallur e papranueshme. Paneli ka marrë dy vendime pasuese në lëndët ku më herët kishte konstatuar shkelje të të drejtave të ankuesve.

Seanca e radhës e Panelit është caktuar të mbahet në shkurt 2016.

Shkeljet e të drejtave të njeriut në lëndën [Desanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it](#)

Ankesat në lëndën (nr. 2012-22) kanë të bëjë me disa hetime në veprat penale kundër ankuesve. Në të gjitha lëndët, prokurorët e EULEX-it në krye të hetimeve kanë hedhur poshtë kallëzimet penale të paraqitura nga ankuesit. Paneli ka konstatuar se prokurorët e EULEX-it nuk i kanë mbajtur të përfshirë ankuesit në mënyrë të mjaftueshme në procesin hetimor. E ata as nuk janë informuar për veprimet e prokurorëve të EULEX-it dhe për kryerjen e hetimit. Për më tepër, ankuesve nuk ju është dhënë asnjë arsye rreth vendimeve të prokurorëve që t'i përfundonin lëndët. Paneli theksoj se përfshirja e viktimave në procesin hetimor dhe nevoja për një shpjegim të arsyetuar rreth përfundimit të tij kanë për qëllim të krijojnë një shkallë të shqyrtimit publik dhe një ndjenjë në mesin e viktimave se ata janë trajtuar në mënyrë të drejtë dhe se kërkimi i drejtësi nga ana e tyre është ushtruar me kujdes. Në përfundim, Paneli ka shpallur se EULEX-i ka shkelur të drejtën e ankuesit sa i përket mjetit efektive (Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - "Konventa") dhe i ka paraqitur një sërë rekomandimesh rreth masave korrigjuese shefit të Misionit të EULEX-it.

Shkeljet në lëndën [Fitim Maksutaj kundër EULEX-it](#)

Në këtë lëndë (nr. 2014-18), Paneli ka konstatuar se vonesat e paarsyetueshme në hetimin penal kundër ankuesit kanë rezultuar në një shkelje të së drejtës së tij sa i përket një procesi të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 6 të Konventës. Sipas pikëpamjes së Panelit, procedurat nuk janë kryer me kujdesin e nevojshëm dhe në mënyrë të duhur. Në adresimin e çështjes së arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave, Paneli ka shqyrtuar rrethanat e veçanta të lëndës dhe ka konsideruar një numër faktorësh të veçantë se janë të rëndësishme me atë vlerësim, pra kompleksitetin e lëndës, sjelljen e aplikantit dhe sjelljen e administratës kompetente. Paneli ka konkluduar se të metat në hetimin e EULEX-it kanë pasur një ndikim negativ në kohëzgjatjen e përgjithshme të hetimit. Përveç kësaj, Paneli ka konstatuar se as sjellja e ankuesit e as kompleksiteti i lëndës nuk kanë kontribuar në këtë vonesë. Paneli gjithashtu ka shqyrtuar pasojat e këtyre të metave tek ankuesi dhe ka arritur në përfundimin se obligimi i prokurorit të EULEX-it për të pasur kujdes të veçantë rreth zgjidhjes së lëndëve bazuar në ndikimin negativ ndaj ankuesit, përfshirë mundësitë për punësim, nuk kanë qenë bindës në këtë rast. Paneli i ka bërë një sërë rekomandimesh rreth masave korrigjuese shefit të Misionit.

Shkeljet në lëndën [L.O. kundër EULEX-it](#)

Kjo lëndë (nr. 2014-32) është paraqitur nga një i afërm i një personi, i cili është i zhdukur që nga viti 1999. Zhdukja e tij fillimisht ishte hetuar nga prokurori special i Republikës së Kosovës (PSRK), prokurorët e EULEX-it në Kosovë dhe kjo është marrë përsipër nga Task Forca Speciale Hetimore (TFSH). Ankuesja ka pohuar se EULEX-i kishte dështuar të kryente një hetim efektiv për zhdukjen e të afërmit të saj. Paneli ka shqyrtuar ankesën në aspektin e dy fazave të veçanta: para dhe pasi që PSRK ka njoftuar EULEX-in Kosovë se do ta hetonte lëndën. Në lidhje me periudhën e parë, Paneli ka gjetur se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme, posaçërisht lidhur me seriozitetin e lëndës dhe se ka dështuar t'i siguronte ankueses informacionin e duhur dhe me kohë lidhur me këtë hetim. Sa i përket periudhës së dytë, Paneli ka kritikuar mungesën e transparencës dhe qartësisë së bazës ligjore sipas së cilës vepron TFSH dhe sa i përket statusit të tij brenda EULEX-it Kosovë. Paneli vuri në dukje se një gjendje e tillë e ka bërë pothuajse të pamundur çfarëdo shqyrtimi të aktiviteteve të TFSH-së. Paneli gjithashtu vuri në dukje se përfshirja e TFSH nuk kishte kontribuar dukshëm për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të ankueses. Pa ndonjë informacion më të qartë dhe më të hollësishëm lidhur me veprimet e TFSH dhe kontributin e tij në hetimin e lëndës, Paneli ka konkluduar se duhej të supozonte se të drejtat e ankueses ishin dhe vazhdonin të shkeleshin. Rrjedhimisht, Paneli ka deklaruar se EULEX-i ka shkelur të drejtat e ankueses sipas nenit 2 (obligimi

për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta), nenit 3 (sa i përket vuajtjes për fatin e paditur rreth të afërmit të saj), nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të Konventës. Paneli gjithashtu i ka bërë rekomandime për masa korrigjuese shefit të Misionit të EULEX-it Kosovë.

Vendimi pasues në lëndën X dhe 115 të tjerë kundër EULEX-it

Lënda ishte sjellë nga 116 romë, persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), të cilët ishin zhvendosur gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe ri-vendosur në disa kampe të PZHBV-së në veri të Mitrovicës. Ankuesit pretenduan se ju ishin shkelur një numër i të drejtave të njeriut gjatë ose si pasojë e qëndrimit të tyre në ato kampe. Në [vendimin e 22 prillit 2015](#) rreth meritave të rastit, Paneli ka konstatuar se EULEX-i në Kosovë ka shkelur të drejtat e ankuesve sa i përket një mjeti efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës. Paneli ka konsideruar se dështimi i EULEX-it që të nisë një hetim me kohë dhe në mënyrë efektive rreth shkeljeve të pretenduara të të drejtave të ankuesve ka dëmtuar mundësitë e tyre që të merrnin një mjet efektiv juridik për dëmin që kishin pësuar. Paneli i ka rekomanduar shefit të Misionit të EULEX-it në Kosovë se duhet të hetoj me autoritetet e Kosovës nëse një hetim mbi shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesve ishte duke vazhduar. Për më tepër Paneli rekomandoj që shefi i Misionit të EULEX-it të udhëzoj prokurorët të marrin parasysh nëse do ta marrin përsipër lëndën.

Në [vendimin pasues](#), Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit të EULEX-it i kishte zbatuar rekomandimet e tij vetëm pjesërisht. Paneli pranoj se shefi i Misionit ka zbatuar rekomandimin e tij për të hulumtuar me autoritetet vendore nëse hetimi lidhur me rastin ishte duke vazhduar, por nuk kishte treguar se ka pasur progres të vërtetë në hetim. Për më tepër, Paneli vuri në dukje se kryeprokurori i shtetit i Kosovës dhe kryeprokurori i EULEX-it kanë vendosur që t'ia caktojnë lëndën ndonjë prokurori të EULEX-it. Paneli ka konsideruar se hapat e marrë nga Misioni ishin të pamjaftueshme dhe se e drejta e ankuesve për mjete efektive ka vazhduar të preket në mënyrë negative në mungesë të një hetimi efektiv. Paneli ka deklaruar se do të vazhdoj shqyrtimin e kësaj lënde.

Vendimet pasuese në lëndën Becic kundër EULEX-it

Në vendimin e tij rreth meritave të lëndës [Becic kundër EULEX-it](#) (miratuar me 11 nëntor 2014), Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesit sa i përket një mjeti efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës dhe Paneli i ka bërë rekomandime për masa korrigjuese shefit të Misionit. Për t'u siguruar që regjistrimi dhe vlerësimi fillestar i ankesave në EULEX, për aq sa ato kanë të bëjnë me mandatin ekzekutiv të Misionit, vlerësohen prej stafit me ekspertizë ligjore dhe me ekspertizë në të drejtat e njeriut dhe si rrjedhojë të komunikohet tek njësitë përkatëse.

Në vendimin pasues të 11 nëntor 2015, Paneli konkludoi se shefi i Misionit kishte zbatuar rekomandimet e tij dhe e mbylli shqyrtimin e kësaj ankese.

Vendimet e pranushmërisë

Paneli ka shqyrtuar tetë lëndë lidhur me fatin e personave që ishin vrarë ose zhdukur që prej vitit 1999 dhe 2000 (lëndët [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R kundër EULEX-it](#) dhe [Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34). Ankesat janë paraqitur nga familjarët e të zhdukurve, të cilët pohojnë se EULEX-i ka dështuar që të kryej hetimet rreth vdekjeve dhe zhdukjet e supozuara të të afërmeve të tyre. Paneli ka konstatuar se ka pasur juridiksion kohor për shqyrtimin e rasteve dhe ka kërkuar nga shefi i Misionit të paraqesë vërejtje shtesë mbi meritat e lëndës. Në veçanti, Paneli ka

kërkuar nga shefi i Misionit nëse sipas tij EULEX-i ka shkelur të drejtat e ankuesit sipas nenit 2 (e drejta për jetë - obligimet procedurale), nenit 3 (ndalimi i torturës, çnjerëzore dhe trajtimin poshtërues), nenit 8 (e drejta për jetë private dhe familjare) dhe nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të Konventës.

Vendimet e papranueshmërisë dhe ato të hequra nga lista e ankesave

Gjatë seancës së qershorit, Paneli ka shpallur tre lëndë të papranueshme. Një lëndë ishte parashtruar jashtë afatit gjashtëmuor të parashikuar me Rregulloren e Punës së Panelit ([Slavica Mikic kundër EULEX-it](#), nr. 2014-38). Në një lëndë tjetër, Paneli ka konsideruar se ankesa ishte e pabazuar ([Bujar Zherka kundër EULEX-it](#), nr. 2014-42). Lënda e tretë lidhej me vdekjen e një pjesëtari të stafit të EULEX-it, që pretendohet se kishte ardhur nga neglizhenca që i është atribuar nga ankuesja Njësisë Mjekësore të EULEX-it ([Liridona Mustafa – Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41). Paneli ka konsideruar se nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të personelit të EULEX-it. Për më tepër, Paneli ka deklaruar se veprimet ose mosveprimet e personelit mjekësor të EULEX-it nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it dhe për këtë arsye ankesa ka dalë jashtë juridiksionit të Panelit.

Paneli ka hequr nga lista e ankesave një lëndë tjetër ([Avni Hajdari kundër EULEX-it](#), nr. 2014-40). Pasi ankuesi nuk ka arritur të siguroj dokumentet e kërkuara nga Paneli dhe nuk kishte mundësi të kontaktohej, Paneli ka konkluduar se ai nuk ka ndërmend të vazhdoj ankesën e tij.

Një lëndë tjetër ([Milica Radunovic kundër EULEX-it](#), nr. 2014-02) ishte gjetur i papranueshëm gjatë seancës së Panelit të mbajtur në muajin nëntor. Paneli ka gjetur këtë ankesë të parakohshme, pasi procedurat rreth të cilat ka pasur ankesë kanë qenë ende të pazgjidhura.

Takimi me shefin e stafit të EULEX-it

Z. John Rouse, shef i ri i stafit të EULEX-it është takuar me Panelin gjatë seancës së nëntorit. Paneli informoj z. Rouse lidhur me mandatin dhe procedurat e tij dhe iu përgjigj pyetjeve të tij në lidhje me punën dhe vëllimin e punës. Paneli dhe shefi i stafit po ashtu diskutuan për bashkëpunimin mes EULEX-it dhe Panelit dhe për të ardhmen e misionit.



Paneli takohet me shefin e stafit të EULEX-it

Nga e majta: Guenael Mettraux, Ola Quarnstrom, John Rouse, Paul Landers, Elka Filcheva-Ermenkova, Katja Dominik, Joanna Marszalik, Magdalena Mierzewska, John J Ryan

Fushata informuese

Paneli dhe Sekretariati kanë vazhduar fushatën e tyre në terren dhe janë takuar me përfaqësues të organeve të ndryshme, përfshirë edhe Avokatin e Popullit të Kosovës të sapo zgjedhur, z. Hilmi Jasharin, znj. Zlata Radovanovic, koordinatore e Zyrës për Kosovë dhe Metohi, si dhe të autoriteteve vendore dhe shoqërisë civile.




Takimi me Avokatin e Popullit të Kosovës

Nga e majta: John J Ryan, Joanna Marszalik dhe Hilmi Jashari

Paneli dhe Sekretariati gjithashtu ka vazhduar me fushatën informuese në Serbi. Paneli është takuar me përfaqësues të qeverisë së Serbisë, duke përfshirë përfaqësues të Zyrës për Kosovë dhe Metohi, si dhe të Komisionit për Personat e pagjetur në Beograd. Përfaqësuesit e qeverisë u informuan mbi punën aktuale dhe praktikën e punës së Panelit, veçanërisht lidhur me personat e vrarë dhe të zhdukur. Paneli është takuar edhe me z. Rastko Brajkovic nga Këshilli Danez për Refugjatë, gjatë së cilës Paneli diskutoi rreth numrit e fundit të lëndëve dhe është informuar mbi çështjet që janë temë e ankesave të parashtruara në Panel.

Statistikat e lëndëve



Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu



SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PSHDNJ

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.